



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:270899

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05472794

C-IV-14-4965

Ankuesi

A P, fshati H, Podujevë.

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 19 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN093-0091 datë 03 qershor 2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **A P** në emër të kompensimit për asistencën sociale për periudhën prej 01 janar 2005 – 14 gusht 2007, t’i paguaj **shumën prej 600.00 €**, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës prej **900.75 €**, përtej shumës së aprovuar refuzohet.
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **104.00 €**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN093-0091, të datës 03 qershor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale nga NSH “Gërmia” (në likuidim). Ankuesi theksoi se gjendja faktike nuk është vërtetuar fare sepse deri në momentin e likuidimit të NSH-së unë kam qenë në listën e pagave dhe e kam marr edhe 20% nga shitja e aseteve të NSH-së në likuidim. Me vendimin e AKP Zyra Regjionale në Prishtinë është refuzuar kërkesa ime si ish punëtor i ndërmarrjes, ku unë kam të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve të qirasë

sepse jam lajmëruar në punë por pa fajin tim jam caktuar në asistencë sociale që e kam marr nga mjetet e qirave të paguara nga lokalet e NSH-së. Ankuesi më tej pohoi se meqenëse NSH-ja nuk ka qenë duke funksionuar si ndërmarrje prodhuese, prona e kësaj NSH-je është dhënë me qira dhe prej qirave ne i kemi marr asistencën sociale dhe në momentin e likuidimit e kemi kërkuar asistencën sociale të papaguar dhe atë prej 01 janar 2005 e deri më 14 gusht 2007 në shumë prej 1,500.75 € që do të thotë 50.00 € në muaj. Ankuesi më tej pohoi se është bërë aplikimi i gabuar i dispozitave të ligjit mbi AKP-në. Në bazë të nenit 23 pika 1 dhe 1.1 të Ligjit mbi AKP-në unë si punëtor i kam dorëzuar formularin me kërkesë të më paguhen mjetet – pagat të cilat janë grumbulluar prej qirave të objekteve të NSH-së. Ankuesi thekson se meqenëse si ish punëtor i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës për marrjen e asistencës sociale nga qiratë e grumbulluara të NSH-së i propozon gjykatës, që të obligohet e paditura që të bjerë vendim që ti paguaj mjetet – pagat e papaguara nga qiratë dhe ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës dhe të avokatit sipas tarifës së OAK si dhe të vendos me një vendim meritore në këtë çështje. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin e kundërshtuar, Formularin e kërkesës për likuidim nr. REF L25 datë 18 shtator 2007, Vendimin e përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale të lëshuar nga NSH “Gërmia” nr. 558 datë 05 qershor 2001.

Me 15 mars 2017, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj përmes së cilës konteston si ekzistencën ashtu edhe shumën e kërkesës dhe më tej i përmbahet qëndrimit se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura në radhë të parë konstaton papranueshmërinë e ankesës në kuptim të Nenit 28.2.6 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033, i cili parasheh se një ankesë duhet dorëzuar në përputhje me kushtet e caktuara në nenet 25 dhe 27 të kësaj Shtojce. Parashtruesi nuk ka paraqitur një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve ligjore mbi të cilat mbështet ankesën si dhe provave përkatëse. Ankesa thjesht i referohet pretendimit se parashtruesit i takojnë mjetet e grumbulluara nga qiratë e lokaleve të NSH-së, pa argumentuar dhe aq më pak provuar këtë pretendim për periudhën kontestuese. Po ashtu, në ankesë nuk përcaktohet se cilat dispozita të Ligjit nr.04/L-034 është shkelur në vendimin e AL, kusht ky për dorëzimin e një ankese pranë DHPGJS sipas nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033. Më tej e paditura thekson edhe njëherë se e kundërshton si ekzistencën e detyrimit ashtu edhe lartësinë e tij si të pabazuar në fakte dhe prova të besueshme. E paditura thekson gjithashtu rregullin bazik në procedurën civile kontestimore sipas të cilit parashtruesi e ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK dhe Neni 23 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033). E paditura dëshiron të sqarojë se fillimisht në formularin e kërkesës, Parashtruesi kishte kërkuar kompensim për mjetet e asistencës sociale për periudhën janar 2005-gusht 2007 si dhe çdo dokument tjetër që Parashtruesi vlerëson se e mbështet apo dëshmon pretendimin e tij. Në përgjigje, Parashtruesi dorëzoi një kopje të vendimit nr.558 datë 06 qershor 2001 ku theksohet se A P vazhdon të mbetet i paangazhuar në punë me arsyetimin se NSH-ja nuk afaron, vendimin nr.874 datë 05 shkurt 2003 për periudhën 01 janar 2003 – 31 mars 2003 ku A P vazhdon të mbetet i paangazhuar dhe në këto data është në asistencë sociale. Mirëpo asnjë nga dokumentet e dorëzuara nuk kanë të bëjnë apo provojnë pretendimin konkret, përkatësisht ndonjë vendim të lëshuar nga NSH ku autorizohen dhënia e asistencës sociale për parashtruesin për periudhën janar 2005 – gusht 2007. Për sa më sipër, AL konstatoi se edhe pas komunikimit me parashtruesin, nuk kishte asnjë provë që të dëshmonte bazën e kërkesës së parashtruesit për kompensim. Prandaj, në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034

për AKP-në, AL me të drejtë konstatoi se dëshmimi i kërkesës i paraqitur nga parashtruesi i kërkesës mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës për dokumente shtesë. Neni i lartpërmendur parasheh: *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:...dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës për dokumente apo dëshmi plotësuese”*. Parashtruesi ndonëse pretendon vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sërish përsërit të njëjtën mangësi si gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës në likuidim, përkatësisht nuk ofron asnjë dokument apo çfarëdo prove konkrete që dëshmon se i ishte njohur një e drejtë për përfitimin e asistencës sociale për janar 2005 – gusht 2007 në shumën arbitrare prej 50.00 € të referuar në kërkesë. Theksohet se barra e provës bie mbi parashtruesin për të vërtetuar pretendimin e tij, të cilën parashtruesi jo vetëm që nuk e bëri në përgjigjen ndaj kërkesës së AL për dëshmi dhe informacion shtesë, por vazhdon të mos e dëshmojë as në procedurën e ankimit këtu. Si rrjedhojë, vendimi i AL, ku konstatohet se kërkesa mbeti jo e plotë edhe pas komunikimit me parashtruesin, është një vendim i drejtë dhe në përputhje të plotë me nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034. Së fundmi, parashtruesi në ankesë pretendon se ka dorëzuar kërkesën në përputhje me nenin 23.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, të cilën në fakt e paditura e konteston. Kjo dispozitë parasheh se një dëshmi e kërkesës së dorëzuar në likuidim duhet ndër të tjera të përmbajë edhe një përshkrim të natyrës së kërkesës, duke identifikuar si ka lindur detyrimi, si dhe dëshmi të hapave ligjorë të ndërmarrë në lidhje me pretendimin dhe të gjitha dëshmitë përkatëse që e dëshmojnë / vërtetojnë atë pretendim. AL në zbatim të nenit 23.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, i dha parashtruesit një mundësi të dytë për të plotësuar kërkesën e tij me dëshmitë mbështetëse, të cilën parashtruesi nuk e bëri. Prandaj, i vetmi vendim që AL mund të merrte në këtë rast është si edhe vendimi që ka lëshuar, pra se dëshmitë e kërkesës ishin dhe mbeten jo të plota edhe pas kërkesës për dëshmi dhe informacion shtesë. E paditura dëshiroj të shtoj se vet dëshmitë e ofruara nga parashtruesi, përkatësisht vendimi nr.558 datë 05 qershor 2001 si dhe vendimi nr. 861 datë 05 shkurt 2003 (bashkëlidhur në ankesë) jo vetëm që dëshmon se NSH-ja nuk ishte aktivitet afarist mirëpo mbi të gjitha konfirmon se parashtruesi nuk ishte i angazhuar në punë dhe detyra të punës te NSH-ja si pasojë e mungesës së aktivitetit afarist. Rrjedhimisht, duke qenë se parashtruesi në fakt rezulton të mos ketë qenë i angazhuar në çfarëdo kompensimi, qoftë edhe në shuma simbolike, rezulton i pabazuar. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe / apo të pabazuar si dhe të Vërtetoj (lërë në fuqi) Vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033.

Me 07 prill 2017 ankuesi dorëzoi përgjigjen e tij në përgjigjen e të paditurës përmes së cilës i konteston në tërësi të gjitha pretendimet e saj. Në mbështetje të saj dorëzoi Listën e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005 (1-9 faqe) si dhe ri – dorëzoi dëshmitë tjera të dorëzuara nga e paditura në mbrojtjen e saj.

Me 05 maj 2017, e paditura dorëzoi në gjykatë kundërpërgjigjen saj duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e ankueses dhe duke i qëndruar në tërësi mbrojtjes së saj.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga pohimet e palëve dhe shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN093-0091, datë 03 qershor 2014, me të cilin vendim, edhe pas kërkesës për dëshmi dhe informacione shtesë ishte refuzuar në mungesë të provave kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale në shumë prej 1,500.75 € për periudhën kohore prej 1 janar 2005 – 14 gusht 2007 nga NSH “Gërmia” (*në likuidim*).

Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Formularin e kërkesës për likuidim ref. L25 datë 17 tetor 2007, Vendimin e përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale të lëshuar nga NSH “Gërmia” nr. 558 datë 05 qershor 2001 dhe Listën e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005; faqe 1-9, (Listë e cila është dorëzuar në disa lëndë të kësaj natyre që janë në shqyrtim në gjykatë si: C-IV-14-4965, C-IV-14-6120, C-IV-14-6448, etj.) si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi për përfundimin e punësimit datë 14 gusht 2007, i dorëzuar si provë (nga e paditura), vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “Gërmia” deri me 14 gusht 2007, kohë edhe kur shumica (apo të gjitha) asetet e NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar.

Nga lista e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005, vërtetohet fakti se ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit shumën bruto prej 600.00 € në emër të asistencës sociale për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2005 (nr. rendor 133). Andaj, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e ankuesit pra shumën prej 600.00 €, duke u bazuar në dëshmitë e lartcekura e veçanërisht duke ia falur besimin listës së punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës në mungesë të dëshmive e refuzon.

Gjykata pasi ka shqyrtuar në tërësi të gjitha dëshmitë e dorëzuara në këtë rast në lidhje me kërkesën për kompensim të asistencës sociale për periudhën objekt kontesti, ka gjetur se pjesa tjetër e kërkesës në shumë prej 900.75 €, për periudhën 1 janar 2006 – 14 gusht 2007, nuk është e mbështetur në prova dhe dëshmi relevante. Siç ka arsyetuar edhe e paditura në mbrojtjen e saj, ankuesi kishte dështuar të dorëzonte prova dhe dëshmi relevante edhe në procedurën e likuidimit kur ishte shqyrtuar kërkesa e tij kreditore nga AL.

Andaj, gjykata vie në përfundim se meqenëse ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale tek NSH-ja dhe se ka ofruar pjesërisht dëshmi se NSH i kishte mbetur borxh kompensimin për periudhën e lartcekur, kështu i takon e drejta në kompensim të mjeteve të asistencës sociale, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me këto raste dhe këtë NSH (AC-I-22-0320, AC-I-22-0465, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj ankueses shpenzimet e procedurës dhe atë në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve, për ankesë në shumë prej 104.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar